REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E OBILIQIT-OPŠTINA OBILIĆ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE
Dalës-Izlazna
Nr. -/-129 Data 30.09.2020
Br. Datum
OBILIQ-OBILIĆ

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

Në mbështetje të nenit 12.2, pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare nr.28 të dt.04.06.2008),nenit 44.1 dhe 47.3, të Statutit të Komunës si dhe nenit 39 të Rregullores së punës së Kuvendit, Kuvendi komunal në mbledhjen e mbajtur me dt.29.09.2020, mori këtë:

V E N D I M

PËR

1. **Dhënien në diskutim publik të Projekt Rregullores për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike.**

2. **Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyren e protokolit të MPL-së, si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.**

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E OBILIQIT
OBILIQ-OBILIĆ
OPŠTINA OBILIĆ
REPUBLIKA KOSOVA

Kryesuesi i Kuvendit Komunal

Burim Gërguri

T'idërgohet
- Kryetarit
- Nënkryetarit
- Kryesuesit
- DAP-së
- DPUKP-së
- DSHPE-**së**
- MPL-së
- Anëtarëve të KK-së
- Arkivit

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosova

Komuna Obiliq
Opština Obilić - Municipality Obiliq

Drejtoria për Shërbimeve Publike dhe Emergjencë

DRAFTE

RR E G U LL O R E
PËR VENDOSJEN, NDËRTIMIN DHE LARGIMIN E OBJEKTEVE TË PËRKOHSHME NË PRONËN PUBLIKE

Obiliq, 2020

Në mbështetje të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika (c), lidhur me nenin 14, paragrafi 14.1 dhe nenit 40, paragrafi 40.2, pika (a) të Ligjit, Nr-03/L-040, për vetëqeverisje lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008), nenit 38, paragrafi 1.3, të Statutit të Komunës së Obiliqit, Nr.I-34, të datës 25.04.2016, Kuvendi i Komunës së Obiliqit, në mbledhjen e mbajtur më datën, _____ miratoi këtë:

RR E G U LL O R E
PËR VENDOSJEN, NDËRTIMIN DHE LARGIMIN E OBJEKTEVE TË PËRKOHSHME NË PRONËN PUBLIKE

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

1. Kjo rregullore përcakton: llojet e objekteve të përkohshme (në tekstin në vazhdim O.P) kushtet, kriteret dhe procedurat për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme nga prona publike në të cilën Komuna e ka të drejtën e menaxhimit.
2. Vendosja dhe ndërtimi i objekteve të përkohshme sipas kësaj rregulloreje, nënkupton të gjitha punët e ndërtimit që janë të nevojshme për ndërtimin e bazës dhe vendosjen e objekteve të tilla (përkohshme).

Neni 2
Fushëveprimi

Objektet e karakterit të përkohshëm mund të vendosen dhe ndërtohen në pronën publike me kusht që të mos pengojnë funksionimin e institucioneve, bizneseve që veprimtarinë e ushtrojnë në OP, nuk pengojnë funksionimin e mjedisit jetësor (kalimin e lirë të këmbësorëve, kalim të emergjencave, zhurma, largimi i mbeturinave dhe aktiviteteve tjera mjedisore).

Neni 3
Përkufizimet

Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë këtë kuptim:
DSHPE - Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë
DPUKP - Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Pronë
DI- Drejtoria e Inspeksionit
DMM- Drejtoria për Mbrojtje e Mjedis
PZHK - Plani zhvillimor komunal
PZHU - Plani zhvillimor urban
PRrU - Plani rregullues urban
PRrH - Plani rregullues i hollësishëm
OP - Objektet e përkohshme

QSHQ- Qendra për shërbime me qytetaret
VNM - vlerësimi i ndikimit në mjedis
MMPH - Ministria mjedisit dhe planifikimit hapësinor
MPB - Ministra e punëve të brendshme

Neni 4.
Llojet e objekteve të përkohshme

1. Objekte të përkohshme në kuptim të kësaj rregulloreje janë:
   1. Lokalet e përkohshme - lokal për kryerjen e shërbimeve profesionale, i cili nuk mund të ketë sipërfaqe më të madhe se 30m² dhe lartësi nga 2.6 deri 3m dhe i cili nuk mund të vendoset para objektit afarist.
   2. Kioska - dyqan i vogël, i vendosur në bazën e betonit, i punuar nga materiali i lehtë, me sipërfaqe max.6m² dhe lartësi deri në 2.5m, ku shiten gazeta, revista, libra, bizhuteri, suvenire, lule e të ngjashme.
   3. Antenat satelitore dhe transmetuese - objekte që vendosen me qëllim të emetimit të valëve të mjeteve të teknologjisë informatike (pajisje elektronike, telefonike e të ngjashme).
   4. Kabinat telefonike - hapësirë e vogël e ndarë prej xhami ose metali e cila shërben për ofrimin e shërbimit telefonik.
   5. Ekranet elektronike reklamuese - pllakë prej lënde të posaçme (prej xhami, argjendi e të ngjashme) të lidhura me aparate të ndryshme, ku me anë të dritës riprodhohen figura, sinjale e të ngjashme.
   6. Strehët e udhëtarëve për pritje të autobusëve - strehë e vendosur ku njerëzit mbrohen nga të reshurat dhe dielli gjatë kohës së pritjes së autobusëve lokal dhe ndër-urban.
   7. Panot dhe tabelat reklamuese - hapësirë e paraparë për reklamime të ndryshme të shoqërive biznesore.
   8. Terrenet sportive – hapësirë e paraparë për krijimin e terreneve sportive me karakter të përkohshëm të tipit të mbyllur apo të hapur për lojëra dhe rekreacion (distanca në mes dy objekteve sportive minimum 250m).
   9. Objekt i përkohshëm para lokaleve - objekt i punuar nga materiali i lehtë (druri, metali, plastika), që mund të shërben për shitjen e mallit në funksion të objektit afarist. Me rrethojë nga xhami, folje plastike e të ngjashme, nga kuota 0.00 të jetë h=1.70m, hapësirë që gjendet para objektit hotelier – afarist me pjesë të mobiluara (tavolina, karrige, çadra dhe të ngjashme), e dedikuar për ofrimin e shërbimeve në funksion të objektit hotelier- afarist.
   10. Ndërtimi i përkohshëm i terasave për tavolinat lëvizëse para lokaleve afariste - hapësirë e cila gjendet para lokalit afarist e punuar me material të lehtë me mundësi ngritje nga tereni nga kuota 0.00 deri në 1.70m – lartësi maksimale të terasës.
   11. Tavolinat lëvizëse (tezgat) – mobiluar lëvizës punuar nga materiali i lehtë (druri, metali ose plastika), që mund të ketë sipërfaqe deri në 3.0m² dhe shërben për shitjen e librave, kartolinave, fotografive, bizhuterive, prodhimeve bujqësore e të ngjashme.
   12. Pajisjet për shitjen e akulloreve, misrit, gështenjave dhe të ngjashme - aparat për përgatitjen e produkteve ushqimore, i cili së bashku me shtëpizën e aparatit, nuk kalon sipërfaqen prej 2.0m² .
   13. Automjetet lëvizëse - automjet i veçantë i atestuar për kryerjen e veprimtarisë për shitjen e ushqimit të shpejtë.

14. Tendat e hapura lëvizëse dhe pavijoneve - me mekanizëm dhe me elemente montuese i cili vendoset mbi vitrinën reklamuese në fasadë të ndërtesës, parqe, sheshe, me konstruksion të ngjitur .
15. Lojërat sezonale në parqe - montimi i elementeve konstruktive të mjeteve–aparateve, të cilat vendosen në një hapësirë në pronën publike të dedikuar për karakter zbavitës.
16. Rrethojat e përkohshme - vendosen nga ana e rrugës për mbrojtjen e hapësirave gjelbëruese. Mënyra e ndërtimit, forma, materiali dhe ngjyra e rrethojave, duhet të harmonizohet me ambientin përreth, por lartësia e tyre nuk mund të jetë mbi 60cm aty ku nuk ka plane, ndërsa për zonat e mbuluara me PzhU, PRrU dhe PRrH kushtet e rrethojave definohen me këto dokumente.
17. Panairet, promocionet dhe marketingu - ekspozitë me produkte të ndryshme të shoqërive biznesore, i cili mund të zgjasë deri në 7 ditë.
18. Gjeneratorët statikë - Pajisje standarde si alternativ për furnizim me rrymë të plotësohet me madhësi .
19. Shpërndarja e infrastrukturës nëntokësore - shtrirja e rrjetit kabllor dhe shfrytëzimi i tubave nëntokësor për vendosjen e rrjetit kabllor (elektrik, internet, telefonik).
20. Muralet dhe grafikët sipërfaqësore – pikturim, skulpturim, ngjyrosje, dizajnim të fasadave të objekteve publike.
21. Kamp-shtëpizat.

Neni 5
Plani i vendosjes së objekteve të përkohshme në pronë publike

1. Objektet e karakterit të përkohshëm, të cekura në nenin 4 , paragrafi 1, pikat 1 deri ne piken 7, të kësaj rregulloreje, vendosen në lokacionin e paraparë me planin e vendosjes së objekteve të përkohshme.
2. Varësisht nga karakteri i planit, plani miratohet, ndryshohet dhe plotësohet nga DPUKP.
3. Për zona të caktuara DPUKP i propozon Kuvendit të Komunës projekt planin me të gjitha elementet përcjellëse për miratim.
4. Plani i cekur në paragrafin 1, pika 8 deri ne piken 20 përmban:
    1. Pjesën tekstuale: me kushtet teknike - urbane të vendosjes së objekteve në pikëpamje të: llojit, karakterit, destinimit, sipërfaqes dhe pamjes së objekteve të përkohshme, zonat dhe afatin e dhënies së tyre.
    2. Pjesën grafike: paraqet caktimin detal për secilin lokacion, kushtet teknike-urbane që ka të bëjë me zonat ku do të vendosen Objekteve të Përkohshme.

Neni 6
Propozimi i planit

1 Propozimi për hartimin e planit është në kompetencë të organit kompetent të Komunës për çështje të planifikimit dhe urbanizmit.
2. Në raste të caktuara, disa punë për hartimin e planit mund t'u besohen personave fizikë dhe juridik, në procedurën dhe mënyrën e paraparë me Ligjin e prokurimit publik në fuqi, e në bazë të detyrave projektuese që i cakton organi i cekur në paragrafin 1 të këtij neni.
3. Gjatë hartimit të Planit për vendosjen e objekteve të përkohshme, pos tjerash duhet respektuar edhe këto kritere:
    3.1 Që të vendosen në pronën publike, në të cilën Komuna e ka të drejtën e pronësisë.

3.2 Që me vendosjen e objekteve të përkohshme, nuk do të krijohen pengesa në lëvizjen e lirë në trotuare dhe hapësira të tjera.
3.3 Që në kryqëzime të rrugëve, të mos zvogëlohet dukshmëria dhe të mos rrezikohet siguria në komunikacion.
3.4 Që të mos dëmtohet vlera mjedisore dhe kulturo – historike.
3.5 Që objekti i vendosur të bëhet në harmoni me kompleksin arkitektonik, duke u bazuar në kriteret e definuara me rregulloret e komunës - PZhU, PRrU dhe PRrH.
3.6 Që vendosja e objektit të bëhet në distancë nga rrugët e kategorizuara, të parapara me Ligjin në fuqi për rrugët dhe kushteve të definuara me rregulloret apo planet aktuale.
3.7 Që objekti i përkohshme të mos pengojë shfrytëzimin normal të objekteve të përhershme.
3.8 Panot dhe tabelat reklamuese duhet të kenë përmbajtje të qartë të reklamimit apo porosisë dhe mos të përdoren për fushata linçuese e fyese.

Neni 7
Kushtet dhe procedurat e vendosjes, ndërtimit dhe largimit të objekteve të përkohshme në pronë publike

1. Objektet e përkohshme vendosen dhe ndërtohen në bazë të lejes për vendosjen/ndërtimin e tyre.
2. Lejen nga paragrafi 1, i këtij neni, për objektet e cekura në nenin 4, paragrafi 4.1, pikat 1 deri 20, e jep organi kompetent DPUKP.
3. Lejimi i vendosjes/ndërtimit bëhet me Aktvendim, i cili përmban: shënimet e shfrytëzuesit, lokacionin, llojin dhe destinimin e Objekteve të Përkohshme, sipërfaqen, kohëzgjatjen e shfrytëzimit, obligimet e shfrytëzuesit lidhur me rregullimin e hapësirës dhe kyçjen në infrastrukturë komunale.

Neni 8.
Kërkesës për leje të vendosjes/ndërtimit

1. Për objektet e cekura në nenin 4, paragrafi 4.1, pikat (1-20) duhet të bashkëngjiten këto dokumente:
1.1 Për lokale të përkohshme dhe kioska:
- kontrata për shfrytëzimin e lokacionit – pronës
- përshkrimin teknik të projektit/projekt ideore
- pjesa grafike e lokacionit

2. Për vendosjen e antenave satelitore dhe shpërndarëse
- kontrata për shfrytëzimin e lokacionit-pronës
- pjesa grafike e lokacionit (skica)
- përshkrimin teknik të projektit /projekti ideore
- skicimi i pikave apo vendet se ku mendohet të vendosen antenat
- pëlqimin mjedisor nga MMPH-ja
- VNM (vlerësimi i ndikimit në mjedis)

3. Për kabinat telefonike:
- kontrata për shfrytëzimin e lokacionit-pronës
- përshkrimin teknik të projektit ideor

- projekti i lokacionit me skicë

4. Për ekranet elektronike reklamuese:
   - kontrata për shfrytëzimin e lokacionit-pronës
   - përshkrimin teknik të projektit
   - projekti i lokacionit me skicë
   - atesti teknik dhe elektronik
   - statika dhe pesha e ekranit
5. Për strehët e udhëtarëve për pritje të autobusëve:
   - kontrata për shfrytëzimin e lokacionit-pronës
   - certifikata e pronës
   - projekti ideor
6. Për panot dhe tabelat reklamuese:
   - kontrata për shfrytëzimin e lokacionit-pronës
   - skica e lokacionit
   - përshkrimin teknik të projektit
   - atesti i qëndrueshmërisë (statika, tokëzimi)

7. Për të gjitha pikat e cekura në nenin 8, paragrafi 1, deri ne paragrafin 7, DPUKP mund të vendos për dhënien e lejes në rast se mungon plani i vendosjes dhe nëse hapësirat përkatëse nuk janë të dhëna në menaxhim operatorëve ekonomik ose personave fizik.
8. Për objektet e cekura në nenin 4, paragrafi 4.2, pikat 1 deri piken 20:
   - Për terrenet sportive dhe rekreacion:
   - skica e lokacionit,
   - kontrata për shfrytëzimin e lokacionit-pronës
   - projektin kryesor me përshkrim dhe para-masa sipas standardeve të projektimit
   - pëlqimin nga fqinjët me të cilët rrethohet parcela në distancë deri 100 m
9. Objektet e përkohshme para lokaleve, ndërtimi i përkohshëm i terasave për tavolinat lëvizëse para lokaleve afariste, etj, nga pika 2 deri ne piken 4:
   - projekti me dimensionet e hapësirës
   - përshkrimi teknik
   - skica e lokacionit
10. Për automjetet lëvizëse për shitjen e ushqimit të shpejtë:
    - certifikata e kualifikimit përkatës për ushtrimin e biznesit
    - skica e lokacionit
11. Për tendat e hapura lëvizëse dhe pavijonet, me mekanizëm dhe me elemente montuese:
    - përshkrimin teknik të projektit
    - skica e lokacionit
12. Për lojërat zbavitëse në parqe, rrethojat e përkohshme, panairet-promocionet dhe shkallët para lokaleve:
    - përshkrimin teknik të projektit – plan-programi
    - skica e lokacionit.
13. Për gjeneratorët statikë:
    - specifikat e gjeneratorit (lloji)
    - atesti për mbrojtje nga rreziqet , të lëshuar nga DSHPE – ja
    - atesti për mbrojtje nga zhurma
    - skica e lokacionit

14. Për aparatet klimatike dhe oxhakët e lokaleve:
- atestet nga prodhuesi
- skica e lokacionit

15. Për shpërndarjen e infrastrukturës nëntokësore, për pajisjet elektronike të teknologjisë informatike, telefonike etj:
- licenca për veprimtarinë përkatëse
- dokumentacionin teknik për të gjitha fazat (projekti)

16. Për muralet dhe grafikët sipërfaqësore:
- skica e lokacionit
- përshkrimin teknik të projektit (projekt idenë)
- dokumenti mbi vërtetësinë e autorit

Neni 9
Leja për anekse ndërtimore

1. Objektet të cilat kanë për destinim një apo më shumë etazhitet për afarizëm dhe biznes dhe të cilat kanë lidhje direkt në hapësirën publike, DPUKP mundë të lejoj aneks ndërtimin e Objekteve të Përkohshme vetëm në katin përdhes dhe katin e parë ku konsiderohet se nuk pengon mjedisin jetësor (kalimin e lirë të këmbësorëve, kalimin e emergjencave, zhurma, largimin e mbeturinave dhe aktiviteteve tjera jetësore) dhe që nuk janë në kundërshtim me PZhU, PRrU dhe PRrH .
2. Parashtruesi i kërkesës është e obliguar që kërkesës për aneks ndërtim ti bashkëngjisë projektin ideor me përshkrim teknik duke ia përshtatur arkitekturën objektit ekzistues .
3. Aneks ndërtimi i përkohshëm duhet të ketë strukturë të lehtë, nuk mund të jenë të murosura nga tullat, betoni ose elemente tjera të forta ndërtimore .
4. Aneks ndërtimet e përkohshme duhet të jenë montazh (për të plotësuar kriteret e largimit për 24 orë) ne rast nevoje
5. Parashtruesi i kërkesës obligohet që të sjellë pëlqimet e 51 % të banorëve të cilët jetojnë në të njëjtën hyrje të objektit ekzistues.

Neni 10
Përparësia në hapësirat publike

1. Në dhënien në shfrytëzim të përkohshëm (sezonale) të hapësirës publike prioritet do të kenë pronarët e lokaleve ekzistuese të cilët kanë lidhje direkt në pronën publike.
2. Në rast të mos shprehjes së interesit për marrjen në shfrytëzim të përkohshëm të pronës publike nga pronarët e objekteve ekzistuese të cilët kanë lidhje direkte në pronën publike, institucioni do ta jep hapësirën publike në shfrytëzim personave të tjerë të interesuar, duke i mundësuar qasje dhe hapësirë të mjaftueshme objektit ekzistues.

Neni 11
Lirimi i hapësirës

Shfrytëzuesit e përkohshëm të hapësirave publike janë të obliguar që të lirojnë hapësirën publike atëherë kur kjo është e nevojshme për institucionet si në rastin e organizimit të panaireve, tubimeve, manifestimeve e festave të ndryshme, zbatimin e planeve zhvillimore dhe rregulluese

dhe se të njëjtit paraprakisht do të njoftohen me shkrim nga organi kompetent 8, ditë para organizimeve të cekura më lartë.

Neni 12
Akti për dhënien e lejes dhe shfuqizim

1. Akti për lejimin e vendosjes/ndërtimit të objektit, lëshohet në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e ushtrimit të kërkesës, nëse janë plotësuar të gjitha kushtet.
2. Shfuqizimi i lejes sipas kësaj rregulloreje mundë të bëhet me akt juridik të veçantë nëse konsiderohet se pala nuk ka vepruar sipas kritereve të përcaktuara në Aktvendimin e mëparshëm.
3. Aktvendimin për shfuqizimin e lejes e merr organi i cili e ka lëshuar lejen në rastet si;
4. Paraqitet nevoja për realizimin e planeve zhvillimore, zonale, rregulluese, të hollësishme dhe detale.
5. Ka kaluar afati i caktuar për shfrytëzimin e përkohshëm të pronës publike.
6. Zhvillimin e veprimtarive të dëmshme për shoqërinë.
7. Pengimin e zhvillimit të jetesë normale në rrethinë.
8. Në Aktvendimin nga paragrafi 3, i këtij neni, caktohet afati për largimin e objektit. Afati nga paragrafi 3, i këtij neni është 15 ditë nga dita e pranimit të Aktvendimit mbi shfuqizimin e lejes.
9. Nëse objekti nuk largohet brenda afatit të caktuar sipas Aktvendimit për largimin e OP, largimin e objektit e bën organi kompetent për inspektim, me detyrim që shpenzimet për largimin e objektit t'i mbulojë poseduesi i lejes për vendosjen e objektit.
10. Ankesa kundër Aktvendimit nuk e ndalon ekzekutimin e Aktvendimit për largimin e objektit të përkohshëm.

Neni 14
Largimi i objektit

1. Shfrytëzuesi i objekteve të përkohshme, është i obliguar që ta largojë objektin në afat prej 15, (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e kalimit të afatit të caktuar në Aktvendim, pa të drejtë kompensimi dhe pa të drejtë sigurimi të një lokacioni tjetër .
2. Nëse shfrytëzuesi i Objekteve të Përkohshme nuk vepron në pajtim me paragrafin (1) një, të këtij neni largimi i objektit do të bëhet nga organi kompetent me shpenzime të vet investitorit.
3. Me rastin e largimit të Objekteve të Përkohshme, Inspektorati komunal nuk mbajnë përgjegjësi për dëmtimin eventual të objektit mjeteve dhe mallit që gjendet në objekt.

Neni 15
Afati i planit për vendosjen e objekteve të përkohshme

1. Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Pronë, harton planin për vendosjen e objekteve të përkohshme dhe i njëjti miratohet për një periudhë (5) pesë vjeçare, nga Kuvendi i Komunës.
2 Pas kalimit të afatit (4) katër vjeçar të implementimit të planit për vendosjen e objekteve të përkohshme e deri në përfundimin e afatit të paraparë në paragrafin 1 të këtij neni nëse nuk ka nevojë për plotësim ndryshim të njëjtit plan i vazhdohet afati edhe për një periudhë 5 vjeçare me automatizëm.

Neni 16
Shqyrtimi i kërkesave dhe e drejta e ankesës

1. Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Pronë, miraton apo refuzon dhënien e aktit (lejes) për kushtet e ndërtimit brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të kërkesës.
2. Në rastet kur miratohet kërkesa caktohen kushtet e ndërtimit të objektit të përkohshëm dhe kriteret e ndërtimit të objekteve të përkohshme.
3. Në rast kur kërkesa për caktimin e kushteve të ndërtimit refuzohet, në aktvendim jepet arsyetim për refuzimin e kërkesës.
4. Kundër aktvendimit nga paragrafi 1, të këtij neni pala e pakënaqur mund të paraqes ankesë brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e marrjes të njëjtit, në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, ankesa dërgohet përmes kësaj Drejtorie.

Neni 17
Kushtet për lëshimin e lejes së përdorimit

Objekti i përkohshëm është i përshtatshëm për përdorim nëse:
1. Mund të përdoret për destinimin e paraparë dhe të ngjashëm.
2. Nuk rrezikon jetën dhe shëndetin e njerëzve.
3. Nuk rrezikon dhe nuk pengon qasjen e shfrytëzimit të objekteve në afërsi.
4. Janë plotësuar kushtet për sigurim nga zjarri, mos pengim të trafikut, si dhe kushtet për mbrojtje në punë.
5. Objekti është ndërtuar sipas kushteve të parapara, në bazë të cilit është dhënë leja.
6. Janë plotësuar kushtet e veçanta, të përcaktuara me dispozitat për mbrojtjen e mjedisit.

Neni 18
Kërkesa për leje te përdorimit

1. Inspektimet e objekteve të përkohshme për plotësimin e kushteve të përdorimit të parapara në nenin 17 të kësaj Rregullore, do të kërkohen nga pala duke përdorur mekanizmin njoftues (në të shkruar përmes (QSHQ), zyrës pritëse në komunë ose me postë).
2. Inspektimet do të bëhen nga autoritetet e Komunës, Drejtoria e Inspeksionit.
3. Kur bëhet kërkesa për inspektim, nga poseduesi i lejes do të ofrohen informatat e mëposhtme:
   3.1. Numri i lejes.
   3.2. Adresa e lokacionit ku do të kryhet inspektimi.
   3.3. Emri dhe numri i telefonit i personit që bën kërkesën.
   3.4. Lloji i inspektimit që kërkohet.
   3.5. Data për të cilën është kërkuar inspektimi (duhet së paku 7 ditë njoftim paraprak).
   3.6. Të ceket nëse inspektimi i kërkuar është ri-inspektim .

Neni 19
Leja e përdorimit

1. Organi kompetent i cili e ka dhënë lejen për ndërtim të objektit të përkohshëm ka për detyrë ta jap lejen për përdorim brenda 15, ditëve nga dita e paraqitjes së kërkesës nëse janë plotësuar kriteret e lejes ndërtimore se objekti është i përshtatshëm për përdorim.
2. Organi nga paragrafi 1 i këtij neni mund të refuzojë dhënien e lejes për përdorim, nëse investuesi nuk i ka plotësuar kushtet që janë përcaktuar në lejen për vendosjen e objektit.

Neni 20
Rrënimi i objektit të përkohshëm

1. Nëse gjatë inspektimit vërtetohet se lëshimet në objektin e vendosur nuk mund të mënjanohen dhe për shkak të atyre lëshimeve ekziston rreziku i drejtpërdrejtë për jetën, sigurinë dhe shëndetin e njerëzve, organi që e ka dhënë lejen për ndërtim nxjerr aktvendimin për rrënimin e objektit përkatësisht largimin e objektit.
2. Ankesa kundër aktvendimit nga paragrafi 1, i këtij neni nuk ndalon ekzekutimin e Aktvendimit.

Neni 21
Mirëmbajtja

1. Shfrytëzuesi i objekteve të përkohshme është i obliguar që të mirëmbajë objektin dhe hapësirën përreth objektit.
2. Nëse shfrytëzuesi i objekteve të Përkohshme nuk e mirëmban objektin dhe hapësirën përreth objektit Inspektorati e urdhëron shfrytëzuesin e objektit për eliminimin e të metave të konstatuara në të kundërtën pasojnë masat ndëshkimore në bazë të Ligjeve dhe akteve nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

Neni 22
Mbikëqyrja

Punët e mbikëqyrjes inspektuese për zbatimin e kësaj rregulloreje, i kryen Drejtoria e Inspeksionit e Komunës së Obiliq.

Neni 23
Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfrytëzuesit e Objekteve të Përkohshme mbajnë të drejtën e shfrytëzimit deri në ditën e kalimit të afatit të caktuar në Aktvendimin paraprakë .

Neni 24
Afati për miratimin e planit

Plani për vendosjen e Objekteve të Përkohshme duhet të miratohet nga Kuvendi i Komunës në afat prej 90, ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje.

Neni 25
1. Në raste konflikti dhe mos përputhje të dispozitave të kësaj Rregulloreje dhe dispozitave të Ligjeve dhe akteve tjera nënligjore, do të aplikohen dispozitat e Ligjit dhe akteve tjera nënligjore që janë të aplikueshme ne Republikën e Kosovës.
2. Kjo rregullore mundë të ndryshohet dhe plotësohet ne procedurë të njëjtë me atë të miratimit nga Kuvendi i Komunës, me propozimet e arsyetuare nga propozuesi.

Neni 26

Për zbatimin e kësaj rregullore do të kujdeset Kryetari i Komunës, Drejtoria e Planifikimit Urban, Kadastër dhe Pronë, Drejtoria e Inspeksionit. Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë.

Neni 27

Hyrja në fuqi

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohen Rregulloret dhe Vendimet e miratuara nga Kuvendi i Komunës së Obiliqit për vendosjen e objekteve të përkohshme në sipërfaqe publike.

2. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Obiliqit kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr-03/L-040 për vetëqeverisje lokale "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", nenit 8 të Rregullores-Nr-01/2016 për procedurat e hartimit dhe publikimit të akteve të Komunave dhe pas shpalljes në tabelën e shpalljeve ose ueb-faqen e Komunës.

Kuvendi i Komunës, Obiliq

Kryesuesi i Kuvendit

_____

01-Nr-_____

Burim Gërguri

Data _____